REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Has,me 13/02/2026

PV. 03

Lënda: Relacion "Për përcaktim përdorimi fondi (Grand Performance), me burim financimi të huaj".

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", Udhëzimit të përbashkët nr. 20 & 01, datë 11.07.2025, mbi shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë (GBP), paraqitet për miratim përdorimi i fondit të përfituar nga Bashkia Has me kapitull financimi te huaj.

Sipas njoftimit zyrtar të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Bashkia Has është shpallur përfituese e fondit në vlerën: **5,999,903.21 lekë.**

Ky fond është me burim financimi të huaj dhe do përdoret për shpenzime kapitale (pa përfshirë paga dhe shpërblime).

Propozohet që fondi të destinohet për projektin:

"Rehabilitim, sistemim, asfaltim Rruga Bregu i Vlahnes – Nikoliq", Njësia Administrative Golaj

Ky investim synon:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale
- Rritjen e aksesit për banorët dhe aktivitetet ekonomike
- Përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së jetës

Miratimi i këtij vendimi mundëson regjistrimin e fondit në kapitullin 02 (financim i huaj), llogaria ekonomike 231 dhe nisjen e procedurave për zbatimin e projektit.

Konceptoi:
Grislanda Bajraktari

Adresa: Sheshi "Dëshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al.